



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	71041-01974-11-2016	Data e Regjistrimit	11/11/2016
Numri i Vendimit	11-2016-5206	Data e Vendimit	11/20/2016

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Nurjeta Tafa

ANËTAR

SEKRETARE Agelina Hristic

Objekti: Kërkesë për heqjen e sekuestros preventive.

Baza Ligjore : Neni 274/3 dhe 275 i K.Pr.Penale.

Përmbledhja e vendimit:

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të kërkuarit ***** dhe përfaqësuesit të Prokurorisë, Prokurorit Gëzim Veizi, Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes si dhe dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët të cilat kërkuar: <?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Kërkuari: Heqjen e masës së sekuestros preventive si pasojë e humbjes së efekteve të sekuestros si pasojë e vendimit të pushimit të çështjes në kuptim të nenit 275 të K. Pr. Penale.

Prokurori: Rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sekuestros preventive pasi procedimi penal është pezulluar dhe ne jemi në pritje të letërporosisë nga autoritet holandeze.

Vëren:

I. Rrethanat e çështjes <?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

1. ***** Pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Durrës, nga ana e kërkuarit ***** është paraqitur kërkesa për heqjen e masës së sekuestros preventive të vendosur në kuadër të hetimit që po kryhej ndaj tij si person i dyshuar për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 i K. Penal, duke qenë se me vendimin e datës 09.10.2016 nga ana e Prokurorisë është vendosur pushimi i hetimeve. Pas paraqitjes së kësaj kërkesë nga ana e gjykatës u administruan fashikujt në lidhje me vendimet e mëparshme të marra në lidhje me caktimin e masës së sekuestros preventive dhe vendimi i fundit rezultoi të jetë vendimi Nr.104/2, datë 06.05.2016, me anë të të cilit kjo gjykatë ka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

vendosur: "Heqjen e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive" mbi llogaritë Nr.49897238001 dhe IBAN AL75208110080000049897238001 (Monedha LEK); Nr.97749235301 dhe IBAN AL33208110080000097749235301 (Monedha LEK) si dhe Nr.97749235302 dhe IBAN AL06208110080000097749235302 (Monedha EUR) pranë bankës Banka Intesa Sanpaolo në emër të shtetasit ***** (Theodhoraq) ***** ; Vazhdimin e masës së sigurimit "Sekuestro preventive" mbi llogarinë Nr.49897235101 dhe IBAN AL96208110080000049897235101 (Monedha EUR) pranë bankës Banka Intesa Sanpaolo në emër të shtetasit ***** (Theodhoraq) ***** ." Bazuar në faktin se tashmë çështja penale në ngarkim të tij është pushuar nga ana e Prokurorisë kërkuesi ***** ka kërkuar heqjen e masës së sekuestros mbi llogarinë Nr.49897235101 dhe IBAN AL96208110080000049897235101 (Monedha EUR) pranë bankës Banka Intesa Sanpaolo, si llogaria e vetme mbi të cilën ekziston ende një mase sekuestroje.

II. Analiza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës

2. Gjykata, pasi u njoh me kërkesën e kërkuesit ***** , me aktet në përmbajtje të fashikujve të gjykimit Nr.104, 104/1, 104/2 Regjistri Themeltar, me vendimin e pushimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës si me qëndrimet e palëve në gjykim, vlerëson se kërkesa e kërkuesit ***** duhet pranuar si e bazuar në ligj dhe prova. Neni 274/3 i K. Pr. Penale parashikon se sekuestro preventive mund të hiqet nëse kushtet e zbatimit të saj kanë ndryshuar. Në rastin në gjykim rezulton se nga vendimmarrjet e mëparshme të gjykatës kanë ndryshuar kushtet e zbatimit të masës së sekuestros mbi llogarinë e kërkuesit ***** në bankën Banka Intesa Sanpaolo në të cilën gjendet e depozituar shuma prej 15554 Euro, për sa kohë nga ana e Prokurorisë është vendosur pushimi i procedimit penal Nr.275/2016 me arsyetimin se **fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale** në zbatim të nenit 328, pika 1, germa "b" të K. Pr. Penale, pasi të ardhurat e kërkuesit ***** janë vlerësuar si të **ardhura të justifikuara dhe të ligjshme**. Neni 274, paragrafi i parë dhe i dytë i K. Pr. Penale duke parashikuar vendosjen e sekuestros në rastet kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me **veprën penale** mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, ose për sendet, **produktet e veprës penale** dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, e ka lidhur caktimin e masës së sekuestros me ekzistencën e dyshimit për kryerjen e një vepre penale. Duke qenë se vetë ***** ka arritur në përfundimin se fakti për të cilin është dyshuar kërkuesi ***** nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, atëherë nuk mund të vazhdojë më zbatimi i masës së sekuestros preventive pasi shuma prej 15554 Euro nuk mund të konsiderohet më si produkt i një vepre penale dhe rrjedhimisht të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

përbëjë objekt sekuestrimi.

3. Edhe pse nga ana e Prokurorisë është arritur në përfundimin se procedimi penal (kupto çështja penale) duhet pushuar, në pjesën urdhëruese të vendimit të pushimit të procedimit penal, është përcaktuar vetëm: “**1. Pushimin e procedimit penal Nr. 275, të vitit 2016, në lidhje me veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit**”, duke mos u shprehur në lidhje me masën e sekuestros preventive të vendosur mbi llogarinë e kërkuarit ***** pranë bankës Banka Intesa San Paolo. Për këto arsye, në zbatim të nenit 275 të K. Pr. Penale, i cili parashikon se: “**Humbja e fuqisë së sekuestros - 1. Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t’i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qenë prodhim ose përfitim nga vepra penale,**” duke qenë se në rastin në gjykim sekuestro e ka humbur fuqinë e saj me pushimin e çështjes penale dhe nga ana e Prokurorisë nuk është marrë parasysh ky fakt në kundërshtim me neni 275 të K. Pr. Penale, gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuarit ***** është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

4. Për sa i përket qëndrimit të Prokurorisë se duke qenë se janë në pritje të letërporosisë nga autoritetet holandeze dhe se për këtë arsye zbatimi i masës së sekuestros duhet të vazhdojë gjykata nuk e vlerëson atë të bazuar në ligjin procedural pasi neni 275 i K. Pr. Penale parashikon shprehimisht se në rast pushimi të çështjes penale pasoja ligjore është humbja e fuqisë së sekuestros. Nga ana tjetër ***** nuk dha asnjë argument se pse kjo masë i shërben hetimit dhe vetëm fakti se janë në pritje të një letërporosie dhe se pas marrjes së saj mund të lindë ndonjë dyshim i arsyeshëm për origjinën e parave nuk e bën të bazuar kërkesën, kur ndërkohë në vendimin e pushimit të çështjes penale vetë ***** parashtron dhe argumenton të gjitha rrethanat se pse ka arritur në përfundim se të ardhurat e kërkuarit ***** janë të ligjshme dhe për këtë arsye fakti nuk përbën vepër penale (në vendimin e pushimit evidentohet se ***** nuk është në kërkim ndërkombëtar, nuk ka qenë ndonjëherë i dënuar, nuk njihet nga autoritetet policore holandeze, familjarët e tij nuk rezultojnë me precedentë penalë dhe se për të ardhurat në fjalë disponon dokumentacionin e nevojshëm si kontrata pune, kontrata shitje subjekti etj). Është kontradiktore dhe e pabazuar që nga njëra anë të arsyetohet se të ardhurat janë të ligjshme dhe për këtë fakt të vendoset edhe pushimi i çështjes penale dhe nga ana tjetër të kërkohet vazhdimi i zbatimit të masës së sekuestros mbi llogarinë e kërkuarit ***** duke bllokuar në këtë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

mënyrë të ardhurat që vetë ***** i ka konsideruar të ligjshme, gjë e cila pasjellë cenimin pa të drejtë të interesave të tij pasurore.

5. Në përfundim të analizës së saj si më sipër, gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesit ***** për heqjen e sekuestros preventive mbi llogarinë pranë Intesa Sanpaolo Bank është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si tillë duhet të pranohet.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Gjykata, bazuar në nenin 274 dhe 275 të K. Pr. Penale, <?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit *****Theodhoraq ***** .<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />
2. Heqjen e masës së sigurimit pasuror “**Sekuestro Preventive**” mbi llogarinë Nr.49897235101 dhe IBAN AL96208110080000049897235101 (Monedha EUR) pranë bankës Banka Intesa Sanpaolo në emër të shtetasit ***** (Theodhoraq) ***** , të caktuar me vendimin Nr.104/2, datë 06.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës pasi masa e caktuar e ka humbur fuqinë e saj.
3. Urdhërohet Intesa Sanpaolo Bank SHA që të zbatojë pikën 2 të këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

U shpall sot në Durrës, më datë 15.11.2016.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.